

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/Republic of Kosovo



Komuna Rahovec  
Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kuvendi Komunal – Skupština Opštine – Municipal Rahovec



PROJEKT - PLANI I PUNËS  
I KUVENDIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY  
2026  
RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)  
Nr./Br./No 01/103 Nr. i faq/Br.str/No.pg 84  
Data/Datum/Date 25.02 / 2026



SHKURT 2026

## Pasqyra e planit 2026

Parathënie.....

Janar.....

Shkurt.....

Mars.....

Prill.....

Maj.....

Qershor.....

Korrik.....

Gusht.....

Shtator.....

Tetor.....

Nëntor.....

Dhjetor.....

## Parathënie

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët dhe funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

Kuvendi i Komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe të planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregulloreve të punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas ligjit;
- Nivelin e tarifave dhe të ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, të dekoratave dhe të titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, të rrugicave dhe të vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës, dhe
- Përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, të dokumenteve fiskale dhe financiare, të planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifën dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Kuvendi i Komunës siguron kushte të punës për mbajtje të seancave të Kuvendit të Komunës, si dhe pjesëmarrje për qytetarët gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që, përmes formave të ndryshme, të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i Komunës, kryen edhe aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësi të saj, përfshirë edhe funksione të tjera, detyra dhe përgjegjësi të padeleguara, si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e Komunës;
- Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZhK), Planit Zhvillimor Urban (PZhU), dhe Planet Rregulluese Urbane (PRRU), si dhe ndryshimin e tyre, dhe
- Themelimin e ndërmarrjeve publike të Komunës.

Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Rahovecit, është dokument i mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet e tjera nënligjore.

Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike, i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe të detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti dhe aktet e tjera nënligjore.

Me këtë plan, synohet arritja e objektivave për vitin 2026, ku Kuvendi i Komunës së Rahovecit planifikon t'i mbajë maksimum 12 (dymbëdhjetë) seanca të rregullta, 6 (gjashtë) prej të cilave në gjashtëmujorin e parë dhe 6 (gjashtë) në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2026, në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në interes të Komunës dhe të qytetarëve të Rahovecit e të cilat janë të proceduara sipas akteve në fuqi:

- Cakton datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit sipas rregulloreve së punës së Kuvendit;
- Planifikon shqyrtimin e raporteve të rregullta të punës së Kryetarit të Komunës sipas ligjit;
- Inkorporon planin e tubimeve me qytetarë të Kryetarit të Komunës;
- Miraton buxhetin, planet investuese, planin vjetor të prokurimit, planin vjetor të punës së Auditorit të Brendshëm, planet rregullative etj.
- Miraton çështje të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas Statutit apo të Rregulloreve së punës;
- Nxjerr rregullore të reja dhe bën harmonizimin e rregulloreve ekzistuese me ligjet në fuqi;
- Inkorporon planin e kryetarit për festa shtetërore e kombëtare.
- Mbikëqyr, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit.

## **Përfundim**

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës, do të ndihmojë dhe të lehtësojë punimet e mbledhjeve të Kuvendit, duke iu ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2026, e që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve.

Me planin e punës janë paraparë të mbahen 12 (dymbëdhjetë) seanca të rregullta, por sipas nevojës, mund të mbahen edhe seanca të tjera, përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme, solemne, siç parashihet me LVL-në dhe Statutin e Komunës.

Për përmbushjen e Programit të punës, Ekzekutivi ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të Kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe të agjendës sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit e të gjitha aktiviteteve, sipas dinamikës së përcaktuar me këtë program - plan, do të përkujdesen kryetari dhe kryesuesi i Kuvendit.

Realizimi i programit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Ekzekutivin e Komunës, e cila duhet t'i përmbahet Planit të Kuvendit për vitin 2026.

Plani i Punës së Kuvendit, sipas dinamikës mujore, përfshin: emërtimin e aktit, propozuesin, afatin e dërgimit nga propozuesi, afatet e shqyrtimeve nga komitetet funksionale përgjegjëse për shqyrtim.

Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2026, do të plotësohet edhe me:

- Miratimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar;
- Propozime për debate dhe propozime përmbajtjesore;
- Propozime për raportime dhe informata;
- Peticione;
- Pyetje të anëtarëve të Kuvendit.

**Shtojcë:** *Plani i punës sipas muajve*

01 Nr. \_\_\_\_/26  
Rahovec, 0.2.2026

**Kryesuesi i Kuvendit**

---

**Fatmir Iska**

## Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026

Rend dite		Organi përgjegjës	Afati i procedimit	Shqyrton	Miraton
1.	Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	15.1.2026	KPF/KK	Kuvendi
2.	Dhënia e betimit të kuvendares Florida Bajraktari dhe kuvendarit Behlul Krasniqi	Zyra Kuvendit	15.1.2026	KPF/KK	Kuvendi
3.	Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa	Ekzekutivi	15.1.2026	KPF/KK	Kuvendi
4.	Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete	Ekzekutivi	15.1.2026	KPF/KK	Kuvendi
5.	Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)	Ekzekutivi	15.1.2026	KPF/KK	Kuvendi
6.	Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për iniciimin e procedurave për themelimin e këshillit për fshatin Hoçë e Madhe	Ekzekutivi	15.1.2026	KPF/KK	Kuvendi
7.	Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzimin të pronës së paluajtshme të komunës – “Park hotel plazha”;	Ekzekutivi	15.1.2026	KPF/KK	Kuvendi
8.	Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzimin të pronës së paluajtshme të komunës, lokali – “Parku i qytetit”	Ekzekutivi	15.1.2026	KPF/KK	Kuvendi
9.	Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për zgjedhjen e anëtarit të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara	Ekzekutivi	15.1.2026	KPF/KK	Kuvendi
10.	Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për pagesën e mëdijëve të anëtarëve të komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës	Ekzekutivi	15.1.2026	KPF/KK	Kuvendi
11.	Shqyrtimi i raportit të punës së ekzekutivit (kryetarit) për vitin 2025	Kryetari-Kabineti	15.1.2026	KPF/KK	
12.	Shqyrtimi i raportit financiar janar – dhjetor 2025	Ekzekutivi -Financa	15.1.2026	KPF/KK	
13.	Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit të raportit të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, viti 2025	Ekzekutivi	15.1.2026	KPF/KK	Kuvendi
14.	Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit të raportit të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, 5 6 dhe 7 janar 2026	Ekzekutivi	15.1.2026	KPF/KK	Kuvendi
15.	Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të dhënies në shfrytëzimin të pronës së komunës	Ekzekutivi	15.1.2026	KPF/KK	Kuvendi
16.	Pyejtjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve	KK/Ekzekutivi	26.1.2026	KPF/KK	

JANAR

Rend dite		Organi përgjegjës	Afati i procedimit	Shqyrton	Miraton
1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	6.2.2026	KPF/KK	Kuvendi
2.	Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e komisionit ad-hoc për shqyrtimin e kërkesave të kandidatëve për këshillin e fshatit Hócë e Madhe	Ekzekutivi	6.2.2026	KPF/KK	Kuvendi
3.	Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për caktimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara	Ekzekutivi	6.2.2026	KPF/KK	Kuvendi
4.	Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për emërimin e komisionit komunal të aksionarëve - Stacioni i autobusëve në Rahovec, 2026	Ekzekutivi	6.2.2026	KPF/KK	Kuvend
5.	Shqyrtimi i Projekt-rregullores për Organizimin e Brendshëm, Sistemin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Rahovecit	Ekzekutivi	6.2.2026	KPF/KK	Kuvendi
6.	Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale "KRM Ekoregjioni" në Rahovec	Ekzekutivi	6.2.2026	KPF/KK	Kuvendi
7.	Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së kuvendit komunal për vitin 2026	Zyra e Kuvendit/KPF	6.2.2026	KPF/KK	Kuvendi
8.	Shqyrtimi i informatës rreth aktiviteteve të KKSb-së për vitin 2025	Koordinatori/Kryetari	6.2.2026	KPF/KK	Kuvendi
9.	Shqyrtimi i vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendës drejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP)	Ekzekutivi	6.2.2026	KPF/KK	Kuvendi
10.	Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-71510057-05058-0 ZK-Rahovec	Ekzekutivi	6.2.2026	KPF/KK	Kuvendi
11.	Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të pjesës së parcelës P-71510057-02240-80 ZK-Rahovec	Ekzekutivi	6.2.2026	KPF/KK	Kuvendi
12.	Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-71510057-08152-0 ZK-Rahovec	Ekzekutivi	6.2.2026	KPF/KK	Kuvendi
13.	Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2025;	Ekzekutivi	6.2.2026	KPF/KK	
14.	Shqyrtimi i kërkesës së Kompanisë Regionale për Mbeturina "Ekoregjioni", për ngritjen e tarifës së shërbimit të mbeturinave	Ekzekutivi	6.2.2026	KPF/KK	
16.	Shqyrtimi i propozim-vendimeve, planeve, strategjive dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi	6.2.2026	KPF/KK	Kuvendi
17.	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi	6.2.2026	KPF/KK	Kuvendi
18.	Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve	Ekzekutivi/KK	6.2.2026	KPF/KK	
19.	Seancë solemne për nder të 18-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës		17.2.2026	KPF/KK	

SHKURT

	<b>Rend dite</b>	<b>Organi përgjegjës</b>	<b>Afati i procedimit</b>	<b>Shqyrton</b>	<b>Miraton</b>
MARS	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	5.3.2026	KPF/KK	Kuvendi
	2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e 2 komiteteve të tjetra ose joobligative	Ekzekutivi	05.03.2026	KPF/KK	
	3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) për vitin 2026	Kryetari/Koordinatori	5.3.2026	KPF/KK	Kuvendi
	4. Bartja (rialokimi) i buxhetit të paspenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual	Ekzekutivi	5.3.2026	KPF/KK	Kuvendi
	5. Shqyrtimi i informatës rreth përfundimit të gjysmëvjetorit të parë 2025/2026	Ekzekutivi	5.3.2026	KPF/KK	
	6. Informatë mbi kontratat publike të Komunës së Rahovecit	Ekzekutivi		KPF/KK	
	7. Informatë rreth Planit për Barim Social	Ekzekutivi		KPF/KK	
	8. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Riatdhesim në Komunën e Rahovecit	Ekzekutivi		KPF/KK	
	9. Shqyrtimi i propozim-vendimeve, planeve, strategjive dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi	5.3.2026	KPF/KK	Kuvendi
	10. Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi	5.3.2026	KPF/KK	Kuvendi
	11. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve	Ekzekutivi/Kuvendi	5.3.2026	KPF/KK	
	<b>Rend dite</b>	<b>Organi përgjegjës</b>	<b>Afati i procedimit</b>	<b>Shqyrton</b>	<b>Miraton</b>
PRILL	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	6.4.2026	KPF/KK	Kuvendi
	2. Shqyrtimi i raportit tremujor financiar janar - mars 2026	D. për Financa dhe Buxhet	6.4.2026	KPF/KK	
	3. Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe të truarëve gjatë sezonit dimëror	D. për Shërbime Publike	6.4.2026	KPF/KK	
	4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e 2 komiteteve të tjetra ose joobligative	Ekzekutivi		KPF/KK	Kuvendi
	5. Shqyrtimi i propozim-vendimeve, planeve, strategjive dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi	6.4.2026	KPF/KK	Kuvendi
	6. Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi	6.4.2026	KPF/KK	Kuvendi
	7. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve	Ekzekutivi	6.4.2026	KPF/KK	

		<b>Rend dite</b>							
		Organi përgjegjës	Afati i procedimit	Shqyrton	Miraton				
MAJ	1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	6.5.2026	KPF/KK	Kuvendi			
	2.	Informatë mbi qarkoren e 1-të të MF-së	D. për Financa dhe Buxhet	6.5.2026	KPF/KK				
	3.	Informatë nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural rreth rregullimit të rrugëve në komunën e Rahovecit për vitin 2025	D. për Bujqësi	6.5.2026	KPF/KK				
	4.	Shqyrtimi i propozim-vendimeve, planeve, strategjive dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi	6.5.2026	KPF/KK	Kuvendi			
	5.	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi	6.5.2026	KPF/KK	Kuvendi			
	6.	Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve	Ekzekutivi	6.5.2026	KPF/KK				
		<b>Rend dite</b>							
		Organi përgjegjës	Afati i procedimit	Shqyrton	Miraton				
QERSHOR	1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	6.6.2026	KPF/KK	Kuvendi			
	2.	Miratimi i Komizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029	D. për Financa dhe Buxhet	6.6.2026	KPF/KK	Kuvendi			
	3.	Rishikimi i buxhetit të Komunës për vitin 2026	D. për Financa dhe Buxhet	6.6.2026	KPF/KK	Kuvendi			
	4.	Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2026	Kryetari-Kabineti	6.6.2026	KPF/KK				
	5.	Raporti i performancës komunale për vitin 2025	Koordinatorët për performancë	6.6.2026	KPF/KK				
	6.	Raporti i punës së KKS-së për 6-mujorin 2026	Kryetari - Koordinatori	6.6.2026	KPF/KK				
	7.	Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në komunën e Rahovecit	D. për Shërbime Publike	6.6.2026	KPF/KK				
	8.	Raport mbi menaxhimin e aseteve komunale (inventari) për vitin 2025	Ekzekutivi	6.6.2026	KPF/KK				
	9.	Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre			KPF/KK				
	10.	Raporti rreth punës 6-mujore të këshillit të fshatit: Hoçë e Madhe për vitin 2026	Koordinatori		KPF/KK				
	11.	Shqyrtimi i propozim-vendimeve, planeve, strategjive dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi/Kuvendi	6.6.2026	KPF/KK	Kuvendi			
	12.	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi/Kuvendi	6.6.2026	KPF/KK	Kuvendi			
	13.	Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve	Ekzekutivi/Kuvendi	6.6.2026	KPF/KK				
	14.	Seancë solemne për nder të 14 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Komunës së Rahovecit	Ekzekutivi/Kuvendi	14.6.2026	KPF/KK				

Rend dite		Organi përgjegjës	Afati i procedimit	Shqyrton	Miraton
KORRIK	1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	KPF/KK	Kuvendi
	2.	Informatë për qarkoren e 2-të buxhetore	D. për Financa dhe Buxhet	KPF/KK	
	3.	Shqyrtimi i raportit financiar janar – qershor 2026	D. për Financa dhe Buxhet	KPF/KK	
	4.	Raport nga DKA-ja rreth përfundimit të vitit mësimor 2025/2026	D. për Arsime	KPF/KK	
	5.	Informatë nga Drejtoria për Bujqësi për 6-mujorin e parë të vitit 2026	D. për Bujqësi	KPF/KK	
	6.	Informatë nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, 2026	D. për Shëndetësi	KPF/KK	
	7.	Shqyrtimi i raportit të ZAP-it për vitin 2025 dhe Plani i Veprimit (Para datës 30 shtator)	Ekzekutivi	KPF/KK	
	8.	Informatë mbi realizimin e planit për mirëmbajtjen e hapësirave të hapura publike në komunën e Rahovecit	D. për Shërbime Publike	KPF/KK	
	9.	Informatë mbi realizimin e planit të punës së Zyrës së Prokurimit, janar – qershor 2026	Zyra e Prokurimit	KPF/KK	
	10.	Shqyrtimi i propozim-vendimeve, planeve, strategjive dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	11.	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	12.	Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve	Ekzekutivi/Kuvendi	KPF/KK	
Rend dite		Organi përgjegjës	Afati i procedimit	Shqyrton	Miraton
GUSHT	1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	KPF/KK	Kuvendi
	2.	Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në Komunën e Rahovecit	D. për Shërbime Publike	KPF/KK	
	3.	Shqyrtimi i propozim-vendimeve, planeve, strategjive dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	4.	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Kryesuesi/Financat	KPF/KK	Kuvendi
	5.	Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve	Ekzekutivi/Kuvendi	KPF/KK	
	6.	Vizitë studimore me kuvendarë jashtë territorit të Republikës së Kosovës	Ekzekutivi/Kuvendi	KPF/KK	

		<b>Rend dite</b>		Organi përgjegjës	Afati i procedimit	Shqyrton	Miraton
SHTATOR	1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	KPF/KK	4.9.2026	Kuvendi	Kuvendi
	2.	Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të Komunës për vitin 2027	D. për Buxhet dhe Financa	KPF/KK	4.9.2026	Kuvendi	Kuvendi
	3.	Shqyrtimi i Planit Operativ për Emergjencë	Ekzekutivi	KPF/KK	4.9.2026		
	4.	Informataë për përgatitjen e viti shkollor 2026/2027	D. për Arsimit	KPF/KK	4.9.2026		
	5.	Informataë rreth muajit të mërgimtarëve për vitin 2026	D. për Kulturë	KPF/KK	4.9.2026		
	6.	Informataë rreth ujit të pijes dhe cilësisë	Ekzekutivi	KPF/KK	4.9.2026		
	7.	Shqyrtimi i propozim-vendimeve, planeve, strategjive dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi	KPF/KK	4.9.2026		Kuvendi
	8.	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi	KPF/KK	4.9.2026		Kuvendi
	9.	Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve	Ekzekutivi	KPF/KK	4.9.2026		
		<b>Rend dite</b>		Organi përgjegjës	Afati i procedimit	Shqyrton	Miraton
TETOR	1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	KPF/KK	5.10.2026	Kuvendi	Kuvendi
	2.	Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën janar – shtator 2026	D. për Financa dhe Buxhet	KPF/KK	5.10.2026		
	3.	Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e normave tatimore	D. për Buxhet dhe Financa	KPF/KK	5.10.2026		Kuvendi
	4.	Shqyrtimi i propozim-vendimeve, planeve, strategjive dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi	KPF/KK	5.10.2026		Kuvendi
	5.	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi	KPF/KK	5.10.2026		Kuvendi
	6.	Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve	Ekzekutivi	KPF/KK	5.10.2026		
		<b>Rend dite</b>		Organi përgjegjës	Afati i procedimit	Shqyrton	Miraton
NETOR	1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	KPF/KK	5.11.2026	Kuvendi	Kuvendi
	2.	Informataë rreth punës së Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	D. për Bujqësi	Kuvendi	5.11.2026		
	3.	Shqyrtimi i propozim-vendimeve, planeve, strategjive dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi	KPF/KK	5.11.2026		Kuvendi
	4.	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi	KPF/KK	5.11.2026		Kuvendi
	5.	Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve	Ekzekutivi	KPF/KK	5.11.2026		

DHEJTOR		Rend dite	Organi përgjegjës	Afati i procedimit	Shqyrton	Miraton
1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	4.12.2026	KPF/KK	Kuvendi	
2.	Raporti mbi realizimin e Planit për vitin 2026, si dhe informatë mbi Planin vjetor të prokurimit publik 2027	Zyra e Prokurimit	4.12.2026	KPF/KK		
3.	Shqyrtimi i raportit të punës së Ekzekutivit për vitin 2026	Kryetari/Kabineti	4.12.2026	KPF/KK	Kuvendi	
4.	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit komunal për vitin 2027	Zyra e Kuvendit	4.12.2026	KPF/KK		
5.	Informatë rreth aktiviteteve të punës së KKSBB-së për vitin 2026	Kryetari/Koordinatori	4.12.2026	KPF/KK		
6.	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për vitin 2027	Kryetari/Koordinatori	4.12.2026	KPF/KK	Kuvendi	
7.	Informatë nga komitetet e tjera dhe komitetet joobligative për vitin 2026	Ekzekutivi	4.12.2026	KPF/KK		
8.	Informatë nga Komiteti për Komunitete rreth aktiviteteve të vitit 2026	Kryesuesi i Komitetit	4.12.2026	KPF/KK		
9.	Raport nga këshilli i fshatit Hoçë e Madhe rreth aktiviteteve për vitin 2026	Koordinatori	4.12.2026	KPF/KK		
10.	Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre	Ekzekutivi	4.12.2026	KPF/KK		
11.	Raportimi i Planit të Integritetit për Komunën e Rahovecit 2026	Koordinatori	4.12.2026	KPF/KK		
12.	Shqyrtimi i propozim-vendimeve, planeve, strategjive dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi	4.12.2026	KPF/KK	Kuvendi	
13.	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi	4.12.2026	KPF/KK	Kuvendi	
14.	Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve	Ekzekutivi	4.12.2026	KPF/KK		

01-Nr.103/26

Datë:25.02.2026

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

